



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01 Nr prot. 060-18366 2024

Datë: 05.10.2024 2024

*Duke u bazuar në dispozitat e nenit 11, 12.2 shkronja c), dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja a) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 2,3, 8 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049 publikuar në Gazetën Zyrtare nr.27/2008, dispozitat e nenit 10 pika 1 të Statutit të Komunës së Klinës nr.01-110-1232/2010 i miratuar më dt. 31.03.2010, dispozitat e Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, në seancën V-të rregullt të Kuvendit të Komunës së Klinës të mbajtur më datë: 30/05/2024, Kuvendi mori këtë:*

**V E N D I M**

1. Miratohet rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në Komunën e Klinës.
2. Rregullorja ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Klinës, lartësinë e taksave komunale dhe përcaktimin e kategorive të liruar nga kjo taksë.
3. Pjes e këtij Vendimi është rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në Komunën e Klinës.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Rregullorja për Tarifat, ngarkesat dhe gjobat komunale nr. 01-434-16778/19, e datës 25.04.2019 si dhe vendimi për plotësim-ndryshim të kësaj Rregulloreje, nr. 06-7778/2021 i datës 04.03.2021.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryetari i komunës në bashkëpunim me drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
6. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

**Njoftohen:**

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



**Kryesues i Kuvendit**  
**Fadil Gashi**